

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“EDENIC FARM” SH.P.K.**

**Neni 1- FORMIMI**

Themelohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“EDENIC FARM”** Sh.p.k me Ortakë **Z. Roland Kërçuku dhe Z. Plarent Paço.**

**Neni 2 - SELIA**

Shoqëria Tregtare **“EDENIC FARM”** Sh.p.k. e ka seline në: Rruga “Lagja nr 2”, Rruga Jurgen Trade, Objekti 1 Katesh, Nr 16/574, Kavaje, Shqipëri.

**Neni 3 - KOHEZGJATJA**

Shoqëria Tregtare **“EDENIC FARM”** Sh.p.k. ka një kohezgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike me afat të pacaktuar.

**Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:

1. Import, eksport, prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshme ku përfshihen: Lule dhe peme decorative, fidane të ndryshme, fruta perime të fresketa, fruta të thata, erëza dhe bimë medicinale, mallra ushqimorë të fresketa, të paketuara, të perpunuara, prodhim të ushqimit të freskët për kafshët, ushqim për bime të ndryshme, vajra bimorë, dherishte për bimët, vazo të ndryshme për bimët, mallra industriale si dhe materiale ndërtimi, tuba dhe panele plastik poliliden dhe të materialeve të ndryshme, PVC, sisteme të gatshme hidroponike, pajisje elektronike, elektrike, ndricues si dhe pajisje për ngrohje dhe ftohje individuale dhe industriale.
2. Aktiviteti i transportit të mallrave të mësipërme me mjete të ndryshme si dhe për llogari të vetë ashtu edhe për të tretë, si dhe çdo veprimtari tjetër të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimeve sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.
3. Menaxhimi, blerja, marrja dhe dhënia me qira, ndërtimi, si dhe shitja e pasurive të paluajtshme.
4. Hapja dhe drejtimi i Agjencive Doganore në të gjithë territorin e Shqipërisë për kryerjen e çdo praktike doganore, pasi të jetë pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme të lëshuara nga organet kompetente.
5. Prodhimi, vetë ose në bashkëpunim me persona të tjerë, të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen brenda vendit si dhe /ose për eksportim.
6. Projektim, dizejnim, ndërtimin, montim, operim, shfrytëzim, menaxhim dhe tregtim të serave dhe sistemeve hidroponike, akuaponike, aeroponike.
7. Prodhim dhe tregtim i produkteve të ndryshme bujqësore të cilësisë bio dhe organike.
8. Projektim, dizejnim, ndërtimin, montim, operim, shfrytëzim, menaxhim dhe tregtim të greenwalleve (mureve të gjelbëruar vertikale) të freskëta.
9. Projektim, dizejnim, ndërtimin, montim, operim, shfrytëzim, menaxhim dhe tregtim të akuakulturës në sferën bujqësore, marine/detare dhe dekorative.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria mund të kryejë, gjithashtu të gjitha



veprimet mbi pasuri të luajshme dhe të paluajshme, industriale, financiare (pasi të jetë pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme të lëshuara nga organet kompetente) dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të ketë pjesmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushet objekti i Shoqërisë.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare "**EDENIC FARM**" Sh.p.k është 100 leke (njqind), i cili do të shlyhet i gjithi nga Ortaket e Shoqërisë. Kapitali perbehet nga 2 kuota.

#### **Neni 6 - Administratoret**

Shoqëria Tregtare "**EDENIC FARM**" Sh.p.k ka si Administrator të saj **Z. Roland Kërçuku**, shtetas shqiptar, lindur më datë 31.03.1981, në Kavajë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 034906718 dhe me nr. personal I10331159K.

Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit të shoqërisë, për një afat 5 vjeçar.

Administratori mund të japë dorëheqjen ose të revokohet nga shumica e ortakeve në çdo moment.

Administratori do të ushtroje të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e shoqërisë.

#### **Neni 7- SHPERBERJA E SHOQERISE**

Shperberja e Shoqërisë Tregtare "**EDENIC FARM**" Sh.p.k mund të vije në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË "EDENIC FARM" SH.P.K**

**Z. Plarent PAÇO**

**Z. Roland Kërçuku**



2

